

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "PINK DREAMS" Sh.p.k.**

Sot, me datë 05 / 10 /2022,

**Znj. Pamela Pepa**, shtetase shqiptare, atësia Agim, lindur më 15.09.1998, në Tirane, banuese në: Tirane, mbajtëse e dokumentit ID J85915064T, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërите Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**PINK DREAMS" Sh.p.k.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "**PINK DREAMS" Sh.p.k.**

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Njesia Bahskiane nr: 8, Rruga Agim Prodani nr: 38, Kinostudio, Tirane.**

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

**Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:**

Organizim i eveneve, i seminareve të ndryshme, organizimin e panaireve, ekspozitave, takimeve, mbledhjeve, kombetare dhe nderkombetare, eveneve kulturore, te modes dhe artistike, te festave dhe pervjetoreve, te lojrave dhe aktiviteteve shlodhese dhe argetuese, te spektaklevë dhe kohes se lire te ideimit dhe krijimit te eveneve te konsulences artistike. Organizim konference shtypi per lancime projektesh, mbikqyrjen e veprimtarive te parashikuara per agjencite e promovimit, sfilatave të modës ose të cdo lloji tjeter, fletëpalosjeve apo videove te ndryshme që reklamojnë aktivitetin tregtar.

Ofrim sherbimi per arredim ambjentesh të ndryshme, Skena koncentrale outdoor (karrike, pode pulte, ndricim).

Veprimtarine ne fushen e publicitetit dhe marketingut, si dhe aktivitetet e peraferta dhe te lidhura me to. Konsulence, ndermjetesim, realizim dhe menaxhim, materiale promocionale harcopy dhe Audiovideo. Regjistrim audiovideo dhe komunikim, prodhimi I programeve skeniko televizive qe lidhen drejtperdrejte me aktivitetet e fushes se spektaklit skenik dhe televiziv. Veprimtari spektakli si dhe te gjitha veprimtarite e nevojshme per organizimin e tyre.

Produksion, prodhim dhe shperndarje te filmave kinematografike, filma me metrazh te shkurter, prodhim dokumentari, videoklipe, prodhime kasetash, botime katalogjesh, reklama

televizive, emisione etj

Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standartet me të larta te etikës

## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakut themelues në vlerën 100.000 (një qind mijë) Lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë.

Kapitali themeltar përbëhet si më poshtë:

- **Znj. Pamela Pepa**, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe 100.000 (njëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

-Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

-Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Znj. Pamela Pepa**, shtetase shqiptare, atësia Agim, lindur më 15.09.1998, në Tirane, banuese në: Tirane, mbajtëse e dokumentit ID J85915064T, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje originale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar Administratorin, **Znj. Pamela Pepa**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### ORTAKET THEMELUES

**PAMELA PEPA**

